

**RREGULLORE
E KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT
“PËR PROCEDURAT E ZHVILLIMIT TË SHORTIT MANUAL
PËR ANKIMET QË I PËRKASIN JURIDIKSIONIT DISIPLINOR”**

Miratuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve me vendimin nr. 21, datë 24.05.2018

Ndryshuar me vendimin nr. 55, datë 27.07.2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve

(e përditësuar)

Në mbështetje të neneve 179, pika 7 dhe 179/b, pika 5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 5, pika 3, shkronja “b” dhe 13, shkronja “d” të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenit 13 shkronja “d” të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Apelit të Gjykatës Kushtetuese” të ndryshuar, Mbledhja e Gjyqtarëve

VENDOSI:

**Neni 1
Objekti**

Kjo rregullore përcakton procedurat e shortit manual:

- a) për caktimin e Kolegjit me tre gjyqtarë (më poshtë Kolegji), i cili do të shqyrtojë paraprakisht ankimin, sipas ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- b) për caktimin e relatorit për çështjen.

**Neni 2
Parimet**

Kjo rregullore bazohet në parimet e transparencës, objektivitetit dhe barazisë së ngarkesës midis gjyqtarëve në Juridiksionin Disiplinor.

**Neni 3
Organizimi i shortit**

Ndryshuar me vendimin nr. 55, datë 27.07.2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve

1. Procedurat e shortit realizohen në prani të të gjithë gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

2. Kryetari i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (Kryetari) drejton shortin në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë rregullore, me ndihmën e Drejtorit të Drejtorisë së Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun.
3. Gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit informohen me e-mail nga Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun, për çështjet e regjistruara në regjistër me numrin përkatës. Gjyqtarët informohen në fillim të çdo shorti për:
 - a) ngarkesën e çështjeve në shqyrtim, nga ku rezulton roli i secilit gjyqtar si anëtar i Kolegjit ose si relator;
 - b) numrin e çështjeve që i janë caktuar me short secilit gjyqtar në rolin e relatorit të Kolegjit, nga fillimi i veprimtarisë së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.
4. Shorti organizohet jo më vonë se 7 (shtatë) ditë nga data e regjistrimit të çështjes së depozituar për gjykim. Shorti hidhet për çdo çështje sipas radhës së regjistrimit të çështjes në regjistrin përkatës.
5. Për çdo rast të organizimit të shortit, Kryetari njofton me shkrim ose me e-mail gjyqtarët, të paktën 24 orë përpara hedhjes së shortit. Njoftimi përmban numrin e regjistrimit të çështjes që do të hidhet në short sipas kësaj rregulloreje, datën, orën, sallën e hedhjes së shortit.

Neni 4

Procedura e hedhjes së shortit

1. Procedura për hedhjen e shortit zhvillohet në mjediset e punës ku zhvillon veprimtarinë Kolegji i Posaçëm i Apelimit.
2. Në çdo rast, shorti hidhet në të njëjtën kohë për caktimin e Kolegjit me 3 (tre) gjyqtarë, si dhe për caktimin e gjyqtarit relator.
3. Në çdo hedhje shorti, çështja identifikohet me numrin rendor që mban në regjistrin e çështjeve të Juridiksionit Disiplinor (JD).
4. Hedhja e shortit, në çdo rast evidentohet në procesverbalin që mbahet nga një sekretare gjyqësore dhe nënshkruhet nga të gjithë gjyqtarët e pranishëm.

Neni 5

Procedura e shortit për caktimin e Kolegjit për shqyrtimin paraprak

Ndryshuar me vendimin nr. 55, datë 27.07.2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve

1. Shorti për caktimin e Kolegjit organizohet sipas përcaktimeve të neneve 3 dhe 4 të kësaj rregulloreje. Në rast se në momentin e hedhjes së shortit, rezulton se njëri prej gjyqtarëve ka 2 (dy) ose më shumë çështje në Juridiksionin Disiplinor në raport me gjyqtarët e tjerë, ky gjyqtar nuk merr pjesë në hedhjen e shortit. Në hedhjen e shortit marrin pjesë, në çdo rast, jo më pak se 4 (katër) gjyqtarë. Në rast se në momentin e hedhjes së shortit rezulton se më shumë se një gjyqtar ka 2 (dy) ose më shumë çështje në Juridiksionin Disiplinor, në raport me gjyqtarët e tjerë, hidhet në short se cili prej tyre nuk do të marrë pjesë në hedhjen e shortit për caktimin e Kolegjit.

2. Rolet e gjyqtarëve shkruhen në shirita të barabartë letre, me germë *Times New Roman 18, bold*. Në 3 (tre) shirita letre shkruhet: “**Gjyqtar i Kolegjit**”, kurse në 4 (katër) shirita letre të tjerë shkruhet: “**Gjyqtar pa rol**”. Shiritat e letrës verifikohen për saktësinë nga të gjithë të pranishmit në sallë nëpërmjet ekspozimit nga Kryetari. Pas verifikimit, Kryetari i palos shiritat në mënyrë të njëjtë dhe i vendos në goglat përkatëse. Goglat, përpara se të hidhen në kutinë transparente, merren në dorë nga gjyqtari që dëshiron, përveç Kryetarit, për të verifikuar njëtrajtshmërinë dhe barazinë e tyre në formë dhe ngrohtësi. Pas këtij verifikimi, Kryetari i vendos goglat në kutinë transparente dhe i përzien, me qëllim sigurimin e barazisë në përzgjedhje.
3. Pas përzierjes së goglave, çdo gjyqtar - duke filluar sipas rendit alfabetik të mbiemrit - tërheq në mënyrë rastësore një gogël. Kryetari përzien goglat pas çdo tërheqjeje dhe i përgatit për tërheqjen nga gjyqtari i radhës. Për çdo gogël të tërhequr nga gjyqtari, Kryetari lexon me zë të lartë përmbajtjen e shiritit të letrës brenda saj.
4. Në përfundim të kësaj procedure, Kryetari lexon edhe një herë emrat e Kolegjit.

Neni 6

Procedurat e shortit për caktimin e relatorit

Ndryshuar me vendimin nr. 55, datë 27.07.2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve

1. Relatori i çështjes caktohet me short, pasi është përzgjedhur Kolegji.
2. Në hedhjen e shortit për caktimin e gjyqtarit relator, marrin pjesë gjyqtarët e Kolegjit që kanë më pak çështje në shqyrtim në numër të barabartë mes tyre si relatorë në Juridiksionin Disiplinor. Në rast se rezulton që vetëm një gjyqtar ka më pak çështje për shqyrtim si relator në Juridiksionin Disiplinor në raport me gjyqtarët e tjerë, ai do të jetë relator i çështjes.
2/1. Në hedhjen e shortit për caktimin e gjyqtarit relator, përjashtohen nga shorti ata gjyqtarë të cilët, në raport me gjyqtarët e tjerë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, kanë më shumë se 1 çështje të caktuar me short në rolin e relatorit, që nga fillimi i veprimtarisë së Kolegjit. Në rastet kur gjyqtarët të cilët do të shortohen për t'u përzgjedhur në rolin e relatorit, kanë, që nga fillimi i veprimtarisë së Kolegjit, më shumë se 1 çështje ngarkesë nga gjyqtarët e tjerë, shorti për përzgjedhjen e relatorit do të hidhet mes gjyqtarëve që kanë ngarkesë numër më të vogël ose të barabartë çështjesh.
3. Procedura zhvillohet sipas përcaktimeve të nenit 5 të kësaj rregulloreje. Në 1 (një) shirit letre shkruhet: “Relator”, kurse në shiritat e tjerë shkruhet: “Gjyqtar i Kolegjit”.
4. Në përfundim të kësaj procedure, Kryetari lexon edhe një herë emrat e gjyqtarëve sipas rolit brenda Kolegjit.

Neni 7

Delegimi

1. Gjyqtari, i cili për arsye objektive, në ditën dhe orën e caktuar mungon në hedhjen e shortit, mund të delegojë të drejtën e tërheqjes së shortit, sipas procedurës së delegimit të përcaktuar në nenet 28 dhe 29, pika 1 të “Kodit të procedurave administrative”.

2. Në aktin e delegimit, gjyqtari përcakton këshilltarin e Njesisë së Shërbimit Ligjor, i cili do të ushtrojë kompetencën e deleguar.

Neni 8

Hyrja në fuqi dhe ndryshimi i rregullores

1. Rregullorja hyn në fuqi me miratimin nga Mbledhja e Gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.
2. Kjo rregullore mund të ndryshohet me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, veçanërisht, në rast se nga zbatimi i saj do të rezultojë shpërndarje e pabarabartë e ngarkesës midis gjyqtarëve.